



Datë: 27.02.2026
Numër Protokolli: 1286/2026

A.nr.1735/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Hava Fekaj, Zyrtare e Lartë për Inspektim Administrativ si procesmbajtëse, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1735/2025 të datës 25.09.2025 e parashtruar nga ankuesi A.H, kundër organit të punësimit: Komuna e Ferizajt, në çështjen juridike “*Kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 27.02.2026, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e pasafatshme ankesa me numër A.nr.1735/2025, të datës 25.09.2025, e parashtruar nga ankuesi A.H.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, A.H (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 25.09.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Organit të Punësimit Komuna e Ferizajt, për shkak të uljes së koeficientit dhe degradimin e titullit të Punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Ferizajt më datë 07.10.2025, ndërsa kjo e fundit më datë 22.10.2025 ka përcjell shkresat e lëndës lidhur me çështjen përkatëse ankimore.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës si dhe referuar pretendimeve ankimore të parashtruara nga ankuesja, ka gjetur se ankesa **është e pasafatshme**, sepse:

Nga administrimi i provave të lëndës rrjedh se ankuesi sipas Akt emërimit të datës 05.01. është i punësuar në pozitën e punës “*Përgjegjës i Pallatit të Sportit* ” në Sektorin e Sportit -Drejtoria për Kulturë Rini dhe sport, në Komunën e Ferizajt .

Më tej, nga shkresat e lëndës rezulton se Kryetari i Komunës së Ferizajt më datë 13.05.2024 ka marr Vendim me Nr.01-160/2024 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Komunale, ku sipas shtojcës Nr. 1 të këtij vendimi, pozita e ankuesit është paraparë *Zyrtar i Lartë për Sport* në kuadër të Sektorit për Sport kështu që si rezultat i klasifikimit ankuesit më datë 27.05.2024 i është lëshuar Akt Emërimi me Nr. 01-225/2024 për pozitën *Zyrtar i Lartë për Sport*, kategoria Profesional 1, dhe me klasën e pagës GJ26, koeficient 5.68.

Ankuesi më datë 25.09.2025 ka parashtruar ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin se i është zvogëluar koeficienti i pagës nga 7.5 (që e ka pasur sipas akt emërimit të datës 05.01.2015), në koeficientin 5.68 respektivisht është degraduar, nga pozita fillestare Përgjegjës i Pallatit të Sporteve "Bill Clinton", ku ka menaxhuar pallatin dhe stafin e saj në pozitën "*Zyrtar i Lartë për Sport*" në kategorinë Profesional 1 dhe se i njëjti ka theksuar se vendimi i Komunës së Ferizajt është i kundërligjshëm, dhe ka propozuar të urdhëroje rikthimin e koeficientit në 7.5, siç ishte në momentin e pranimit në punë, sipas Akt emërimit të datës 05.01.2025, rikthimin e titullit të punës që pasqyron nivelin e tij akademik dhe përvojën profesionale, si dhe detyrojë kompensimin retroaktiv për pagën e humbur nga data e uljes së koeficientit deri në ditën e rikthimit të gjendjes fillestare.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranunshmërinë e ankesës iu referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrarët Publikë, përkatësisht nenit 27 paragrafi 3, ku përcaktohet se: *3. Nëpunësja/i civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil, si dhe dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 124 paragrafit 1 dhe nenit 127 paragrafi 1, ku përcaktohet se: 124.1.,Pala ka drejtë të ushtrojë mjetet juridikë administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e tij juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim, neni 127 paragrafi 1: l. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ..., dhe si rrjedhojë, duke bazuar në kuadrin përkatës ligjor si dhe nga analizimi i provave të lëndës, Kolegji konstatoi se ankesa është e pasafatshme, ngase ankuesi Aktin e Emërimit 01 Nr.01-225/2024, e ka nënshkruar më datë 31.05.2024, ndërsa, ankesën në Këshill e ka parashtruar me datë 25.09.2025., gjegjësisht 16 muaj pas nënshkrimit të aktit të emërimit. Po ashtu, Kolegji në baze të shkresave të lëndës ka gjetur se ankuesi Aktin e Emërimit e ka nënshkruar pa ndonjë vërejtje, çka nënkupton se i njëjti me aktin e nënshkrimit ka qenë në dijeni titullin e pozitës, kategorinë e pozitës si dhe klasën e pagës, andaj në vlerësim të Kolegjit ankuesi me asnjë prove nuk e ka argumentuar se ankuesi ka parashtruar ankesë brenda afatit ligjor prej 30 ditësh nga dita e nënshkrimit të aktit të emërimit qofte në institucion apo edhe në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës deri me datë 25.09.2025.*

Andaj, referuar fakteve si lart, Kolegji erdhi në përfundimin se ankesa A.nr.1735/2025 e datës 25.09.2025 është parashtruar jashtë afatit ligjor prej 30 ditësh, të përcaktuar me nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe si e tillë është e pa pranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Përmbledhur si me lart, e duke u bazuar nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 te Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur, e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1735/2025

Hava FEKAJ

Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- *Ankuesi, A.H;*
- *Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Ferizajit; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*